REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 3165/1 prot. Tiranë, më 17.11.2026

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektligjin "Për Byrotë e Kreditit"

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Zyra e Komisionerit") ka administruar shkresën tuaj me nr. 8372 prot., datë 30.10.2026, nëpërmjet së cilës përcillni për mendim projektligjin "Për Byrotë e Kreditit", së bashku me dokumentacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së projektligjit vlerësojmë pozitivisht parashikimet që synojnë garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale në kuadër të veprimtarisë së byrove të kreditit, veçanërisht lidhur me respektimin e parimeve të përpunimit, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave, si dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave.

Megjithatë, duke marrë në konsideratë natyrën dhe volumin e të dhënave personale që do të përpunohen në kuadër të kësaj veprimtarie, vlerësojmë të nevojshëm saktësimin dhe plotësimin e disa dispozitave të projektligjit, me qëllim garantimin e respektimit të parimeve dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (në vijim "ligji nr. 124/2024").

Lidhur ***me shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 17 të projektligjit***, sugjerojmë rishikimin e formulimit të fjalisë, pasi në përmbajtjen aktuale ajo parashikon transmetimin pranë Byrosë së Kreditit të informacioneve për të cilat ofruesi është në dijeni ose ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se janë të pasakta, të rreme ose të paplota. Në këtë kuadër, sugjerojmë saktësimin e kësaj pike, duke parashikuar **mostransmetimin** e këtyre informacioneve, në përputhje me parimin e saktësisë së të dhënave personale.

Për pikën 4 të nenit 21 të projektligjit sugjerojmë rishikimin e formulimit të saj, pasi parashikimi se afatet e ruajtjes dhe kategoritë e informacionit kreditor "*...mund të përcaktohen ndryshe në Kodin e Sjelljes*" mund të krijojë paqartësi në interpretim, duke

lënë të kuptohet se në këtë mënyrë mund të ndryshohen edhe afatet maksimale të ruajtjes apo të zgjerohen kategoritë e të dhënave të përcaktuara nga ligji.

Në këtë kuadër, sjellim në vëmendje se, sipas pikës 1 të nenit 35 të ligjit nr. 124/2024, Kodet e Sjelljes kanë për qëllim specifikimin e zbatimit të kërkesave të këtij ligji. Për rrjedhojë, vlerësojmë të nevojshëm qartësimin e dispozitës, në mënyrë që Kodi i Sjelljes të shërbejë për detajimin e zbatimit të detyrimeve ligjore, pa ndryshuar apo tejkaluar kufijtë e përcaktuar nga ligji, në përputhje me parimet e minimizimit të të dhënave dhe kufizimit të ruajtjes.

Lidhur ***me nenin 29 të projektligjit***, sugjerojmë rishikimin e dispozitës, me qëllim harmonizimin e titullit me përmbajtjen e saj pasi, megjithëse titullohet "Kufizimi i përpunimit të të dhënave personale", parashikimet e saj rregullojnë të drejtën e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar përpunimin. Në këtë kuadër, vlerësojmë të nevojshëm qartësimin e së drejtës që synohet të rregullohet, duke mbajtur në konsideratë se e drejta e kundërshtimit (*parashikuar edhe në nenin 28 të këtij projektligji*) dhe ajo e kufizimit të përpunimit përbëjnë dy të drejta të ndryshme sipas ligjit nr. 124/2024. Gjithashtu sugjerojmë korrigjimin e numërtimit të pikave të dispozitës.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson se me reflektimin e këtyre sugjerimeve projektligji është konform legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Blerta Nerguti